



## KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

### VENDIM

Nr. 72, dt. 03. 04. 2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03. 04. 2015, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për ark. Maksim Mitrojorgji,

### VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë A, me nënkategoritë A/3, A/4, sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e liçensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të ark. Maksim Mitrojorgji.
  2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin dhe pajisjen e Ark. Maksim Mitrojorgji me licencë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë A, me nënkategoritë A/3, A/4.
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**